

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6188  
E premte, 8 dhjetor 2020  
çmimi 0.40 €

OBİ u bënë thirrje  
vendeve anëtare ta  
njojnë pavarësinë e  
Kosovës | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

POZITA DHE OPOZITA PËRPLASEN NË KUVEND PËR ZHVILLIMET NË VEND

## OPOZITA KËRKON SHPËRBËRJEN E KUVENDIT | FAQE 4-5



Deputetët e partive opozitare kanë kërkuar shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Në seancën parlamentare të së enjtes ata kanë thënë se partitë politike duhet të ulen dhe të merren vesh për zgjedhjet e reja parlamentare. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se ky koalicion qeverisës po e mban peng vendin. Kritika ndaj qeverisë ka shprehur edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu. Mirëpo shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, i ka mohuar kritikën e partive opozitare.

## NUK KA PËRAFRIM TË QËNDRIMEVE NË DIALOGUN NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË | FAQE 3

Në Bruksel ka përfunduar të enjten takimi në nivel të ekspertëve në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ku temë e

diskutimit ishin pensionet dhe kadastra. Qeveria e Kosovës ka njoftuar se edhe pas një diskutimi të gjatë ende nuk ka përaftrim të qëndrimeve. "Sidoqoftë,

kishte pajtim që diskutimi i këtij elementi të marrëveshjes së përgjithshme midis dy vendeve të vazhdojë në takimin e radhës", ka njoftuar Qeveria e Kosovës



## DUHET BASHKËPUNIM MË I MIRË NË MES TË KUVENDIT DHE QEVERISË

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



CAKAJ: KONGRESISTI ENGEL E  
THA QARTË, SERBIA TA NJOHË  
REPUBLIKËN E KOSOVËS F. 2

HOXHAJ PRET NË TAKIM SHEFIN  
E EULEX-IT, DISKUTOJNË PËR  
GJYKATËN SPECIALE F. 5

KOSOVA ME DOKUMENT  
STRATEGJIK PËR MBROJTJEN  
DHE PROMOVIMIN  
E TË DREJTAVE TË NJERIUT F. 7

OKMF-JA NË KLINË  
PAJISËT ME BARNA  
PËR TRAJTIMIN E COVIDIT F. 10

### EKONOMI

BËHET THIRRJE QË  
BIZNESET T'I RAPORTOJNË  
RASTET E KORRUPSIONIT F. 9

TË PABARABARTË  
PARA LIGJIT F. 8



### SPORT

BALLKANI U RIKTHEHET  
FITOREVE, LLAPI MPOSHTI  
ARBËRINË F. 12

## CAKAJ: KONGRESISTI ENGEL E THA QARTË, SERBIA TA NJOHË REPUBLIKËN E KOSOVËS

TIRANË, 10 DHJETOR (ER) - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punë të Jashtme në Qeverinë e Shqipërisë, Gent Cakaj, ka vlerësuar lart fjalimin e presidentit të Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve Amerikanë, Eliot Engel, duke thënë se ai shprehu fare qartë jo vetëm thirrjen që Serbia të pajtohet me realitetin e ri në Ballkan, duke njohur Republikën e Kosovës, por edhe absurditetin e plotë të pengimit të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Cakaj, duke iu referuar fjalimit të fundit të kongresistit mbi Ballkanin, ka shkruar në

llogarinë e vet në "Facebook" se derisa ai është i qartë në rëndësinë e vënies së drejtësisë për këdo që ka kryer krime ai, po ashtu, thekson se Serbia pothuajse s'ka bërë asgjë për ndëshkimin e krimeve të luftës, duke përmendur veçanërisht rastin e vëllezërve Bytyqi. "Kongresmeni Engel ka qenë një prej zërave më të vyer, mbështetësve më të mëdhenj dhe personave më të angazhuar për pavarësinë e Republikës së Kosovës, për tri dekada radhazi. Për këtë ai meriton falënderime të pamata dhe mirënjohje të pafundme", ka shkruar Cakaj.



## Raportuesja në PE prezanton draftraportin për Shqipërinë, kërkon përmbushjen e kushteve

TIRANË, 10 DHJETOR - Raportuesja për Shqipërinë në PE, Isabel Santos, ka prezantuar draftraportin për Shqipërinë, sipas së cilës, është fillestar dhe në vijim do të ndryshohet. Ajo ka bërë thirrje që marrëveshja e 5 qershorit për ndryshimet në Kodin Zgjedhor të arritura me konsensus mes palëve, të ruhet në të mirë të vendit.

Santos kërkon që Shqipëria t'i përmbushë të gjitha kushtet e caktuara nga BE-ja, edhe pse nuk mbron punën e madhe që është bërë në këtë drejtim. "Do ta vazhdojmë punën me delegacionin e Shqipërisë dhe BE-në, me ambasadorin Soreca. Dua t'i falënderoj ata që kanë punuar ngushtë me stafin tim që ta prezantoj këtë draftraport në kohën e duhur.



Faleminderit për informacionin! Është draft fillestar. Ka mundësi të ndryshohet sërish. Për shkak të

disa kufizimeve, s'kam pasur mundësi t'i sjell të gjitha faktet. Teksti do të jetë më substancial në vazhdim. Patjetër që jemi

përqendruar te reformat. Në fakt, nuk ka ndryshime thelbësore me të tjerat. Pikëpamjet tona s'kanë

ndryshuar me ato që kemi thënë më parë. Në draftraportin tim kam ndjekur edhe pikëpamjet e KE-së", ka thënë ajo.

Santos ka thënë se kërkesat që ka bërë KE-ja duhet të plotësohen. "Kam edhe shqetësime që i kam prezantuar në raport. Jam e shqetësuar për shoqërinë civile, pjesëmarrjen e saj në proceset politike. Duhet të përfshihet. Të vijojë reforma kundër korrupsionit e krimin të organizuar, të përfundohet reforma në drejtësi. Shumë gjëra për të punuar. Të gjitha forcat politike duhet të përfshihen për normalizimin e jetës politike në vend", është shprehur raportuesja për Shqipërinë në PE, Isabel Santos.

## Meta kalon në heshtje ligjin për buxhetin faktik 2019

TIRANË, 10 DHJETOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka kaluar në heshtje ligjin për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2019. Përmes një deklarate për media bëhet me dije se presidenti Meta ka vlerësuar ta lë në heshtje këtë

ligj, por duke kërkuar vëmendjen e institucioneve përgjegjëse për të marrë masa, për të mos lejuar përsëritjen e treguesve të tillë në nivel financiar për vendin. "Raporti i buxhetit faktik tregon mosrealizimin e

treguesve fiskalë të buxhetit të vitit 2019 për shkak të mungesës në vazhdimësi të një planifikimi joreal të të ardhurave publike dhe, për rrjedhojë, edhe të shpenzimeve buxhetore", ka thënë Meta.



# Nuk ka përafrim të qëndrimeve në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë

Në Bruksel ka përfunduar të enjten takimi në nivel të ekspertëve në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, në të cilin temë e diskutimit ishin pensionet dhe kadastra. Qeveria e Kosovës ka njoftuar se edhe pas një diskutimi të gjatë, ende nuk ka përafrim të ndjeshëm të qëndrimeve. “Sidoqoftë, kishte pajtim që diskutimi i këtij elementi të marrëveshjes së përgjithshme midis dy vendeve të vazhdojë në takimin e radhës”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës

**EPOKA E RE****Qendresa RAMA**

**BRUKSEL, 10 DHJETOR** - Me ndërmjetësim të emisarit special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, delegacioni i Kosovës, i prirë nga koordinatori shtetëror Skender Hyseni, ka zhvilluar të enjten në Bruksel takimin e radhës me delegacionin serb. Temë e diskutimit ishin pensionet dhe kadastra. Sipas njoftimit të Qeverisë së Kosovës, ky diskutim ishte

vazhdimësi e trajtimit të këtyre çështjeve në takimin e kaluar më 29 tetor 2020. “Edhe pas një diskutimi të gjatë, ende nuk ka përafrim të ndjeshëm të qëndrimeve. Sidoqoftë, kishte pajtim që diskutimi i këtij elementi të marrëveshjes së përgjithshme midis dy vendeve të vazhdojë në takimin e radhës”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Pas këtij takimi ka folur drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç. Ai ka thënë para gazetarëve se në

këtë takim pala serbe prezantoi “dokumentacionin me parimet” se si duhet t’i zgjidhin çështjet pronësore sipas standardeve ndërkombëtare. “Marrë parasysh që pozicionet e Beogradit dhe Prishtinës janë shumë të kundërta, ajo që kemi propozuar është që t’i vendosim parimet. Jo sipas dëshirave, por sipas asaj se si zgjidhen çështjet pronësore gjithkund në botë. Kemi qëndrime të kundërta, ku Prishtina paraqitet me interesat e veta, kurse Beogradi është

racional dhe realist. Ne ofrojmë dëshmitë tona se çka është financiar, kush është pronar”, ka thënë Petkoviç. Sipas tij, me inicimin e çështjeve pronësore jepet kontribut për zgjidhjen e të gjitha problemeve në procesin e dialogut me Kosovën.

Petkoviçi tha se çështja e parë që është ngritur nga Serbia në takimin e sotëm në nivel ekspertësh ka qenë ajo e formimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe që, sipas tij, kjo është çështja kryesore që dialogu të jetë i suksesshëm.


Delegacionet fillimisht janë takuar ndaras me të dërguarin e posaçëm të BE-së për dialog, Miroslav Lajçak, më pas do ta kenë takimin e përbashkët.

Takimi i 10 dhjetorit vjen pas një pauze gjatë pas së cilës nuk ka

pasur takime. Për këtë shpesh si arsytim është përmendur pandemia e koronavirusit, mirëpo disa diplomatë në BE pohojnë se për ngadalësimin e dinamikës së dialogut ka ndikuar refuzimi i Kosovës që të diskutohet për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, sipas marrëveshjes së arritur kohë më parë, dhe insistimi i Serbisë që kjo temë të jetë në tryezën e bisedimeve.

Pala e Kosovës vazhdon të insistojë se këto diskutime janë politike e jo të ekspertëve apo teknike. Në BE, ndërkaq, takimin e së enjtes e konsiderojnë takim të ekspertëve.

Takim në nivelin e lartë, ku marrin pjesë kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë Aleksadar Vuçiq, nuk ka pasur që nga shtatori.



## Reçica dhe ambasadori zviceran pajtohen për vazhdim të projekteve në të mirë të qytetarëve

**PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER)** - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Konfederatës Zvicerane në Kosovë, Thomas Kolly, me të cilin kanë bashkëbiseduar lidhur me bashkëpunimin e mirë në mes të dy shteteve tona.

Ministri Reçica e ka njoftuar ambasadorin Kolly lidhur me projektet dhe reformat që ka ndërmarrë si ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale në këtë

mandat qeverisës, si dhe për zbatimin e marrëveshjes për sigurime sociale, ku tashmë qytetarët e Kosovës janë duke gëzuar përfitimet e fituara në shtetin e Zvicrës.

Ministri Reçica dhe ambasadori Kolly kanë biseduar edhe për nënshkrimin e marrëveshjes për fazën e tretë të EYE Project (Enhancing Youth Employment), projekt i cili edhe më tej do ta ndihmojë rininë e Kosovës për edukim dhe punësim.

“Gjithashtu, biseduam edhe për mundësinë e angazhimit të të rinjve tanë për aftësim profesional dhe punësim sezonal në Zvicër”, ka thënë ministri Reçica.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, ministri Reçica e ka falënderuar ambasadorin Kolly për ndihmën që ka dhënë Zvicra në çdo sferë të zhvillimit tonë si shtet, me ç’rast dhe janë pajtuar për vazhdimin e projekteve në të mirë të qytetarëve tanë.





POZITA DHE OPOZITA PËRPLASEN NË KUVEND PËR ZHVILLIMET NË VEND

# OPOZITA KËRKON SHPËRBËRJETEN E KUVENDIT

Deputetët e partive opozitare kanë kërkuar shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Në seancën parlamentare të së enjtes ata kanë thënë se partitë politike duhet të ulen dhe të merren vesh për zgjedhjet e reja parlamentare. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se ky koalicion qeverisës po e mban peng vendin. Kritika ndaj qeverisë ka shprehur edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu. Mirëpo shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, i ka mohuar kritikën e partive opozitare

votat për ta rrëzuar, të ulemi e të merremi vesh për një datë që të shpërbëhet Kuvendi. Pra, ky Kuvend është jofunksional”, ka thënë Tahiri.

Ushtuesi i shefit i grupit parlamentar i LV-së, Liburn Aliu, ka qenë edhe më i ashpër me qeverinë. Ai ka akuzuar qeverinë. Hoti për keqmenaxhim të situatës me Covid-19, duke thënë se nuk ka oksigjen në spitale për pacientët që kanë nevojë. “Nuk ka ku shkon më keq. Nga kjo qeveri nuk kemi oksigjen në spitale. A është ky kulmi? Kryeministri Hoti para një muaji na pati thënë se nuk keni parë akoma. A është kjo ajo gjëja që po shohim tani e cila është jashtë imagjinatës sonë?”, ka thënë Aliu.

Ai ka deklaruar se qeveria Hoti e ka formën jashtë demokracisë dhe jashtë legjitimitetit. Sipas Aliut, kjo qeveri nuk i përgjigjet askujt dhe nuk qëndron për asgjë. “Një qeveri në mungesë dhe një qeveri e asgjësimit, një qeveri që u formua nga një deputet që është i dënuar me burgim. Andaj, si e tillë në

originë, fillon me heqjen e reciprociteti në veprim të parë. Mënjaron punën e vetingut për drejtësi, largon bordet e ndërmarrjeve publike, të cilat patën konkurse formalisht, por jo edhe rezultate nga ato”, ka thënë ai, duke vazhduar kritikën ndaj qeverisë Hoti. “Kjo qeveri ka fyer dhe ka përzënë këdo që i ka kërkuar llogari edhe për çështjen e të pagjeturve dhe të luftës. Kësaj qeverie iu vodh kasaforta dhe e zhduki Task Forcën brenda policisë”, ka thënë Aliu.

Këto kritika i ka mohuar LDK-ja, partia që udhëheq qeverinë. Madje shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Arben Gashi, ka kritikuar Lëvizjen Vetëvendosje për kohën sa kishte udhëhequr Qeverinë e Kosovës. Ai ka thënë se vendi në kohën e qeverisjes së Lëvizjes Vetëvendosje ishte drejt kolapsit ekonomik dhe shëndetësor. “Ne sot po shohim vazhdim e përfaqësuesve të moralit të pavërtetës dhe gënjeshtërisë në Kuvendin e Kosovës. Zotëri, ne kemi një rezultat zgjedhor që është certifikuar dhe demokracia

bazohet mbi rezultatin zgjedhor. Demokracia është sport pak më i rëndë se populizmi juaj i shpërfaqur në Kuvend, rrugë e në secilin autoritet ku ju pak keni pasur mundësi të udhëhiqni. Por, po i shohim modelet e udhëheqjes suaj në Prishtinë e Prizren, korrupsion e nepotizëm. Ky është modeli juaj”, ka thënë ai. Arsyje e shkuarjes së vendit në zgjedhje mund të bëhet moszgjedhja e presidentit të ri të vendit.

Në qëndrimet e tyre publike, subjektet politike kanë shprehur qëndrime të kundërta për këtë postë. AAK-ja ka bërë me dije se votat e deputetëve të saj shkojnë veç për kandidatit e tyre, Ramush Haradinaj. Sipas udhëheqësve të kësaj partie, nëse partitë e tjera politike nuk e përkrahin Haradinajn për president, atëherë vendi mund të shkojë në zgjedhje të reja.

Në anën tjetër, edhe kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se kjo parti e voton presidentin vetëm nëse është kandidat i saj. “Republika jonë është mbi interesat politike dhe

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Pozita dhe opozita kanë vazhduar përplasjen e tyre edhe të enjten në seancën e Kuvendit të Kosovës. Në seancën plenare deputetët e opozitës kanë kritikuar qeverinë për mosfunksionim të qeverisjes. Ata kanë kërkuar shpërbërjen e Kuvendit dhe caktimin e datës së zgjedhjeve të reja.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard

Tahiri, ka thënë se Kuvendi i Kosovës është jofunksional dhe pozita e opozita duhet të caktojë një datë për ta shpërbërë atë. “Viti 2020 është viti që shoqëria jonë pësoi një degradim të madh në ekonomi, shëndetësi, jo që po pëson, por po e rrënon arsimin. Ky është rezultati i 6 tetorit, i qeverisë së shpresës. Sot po pretendojnë që po qeverisin një koalicion që asnjëherë nuk i ka mbi 35 deputetë në sallë. Është koha që edhe ju që po mbani peng vendin, e edhe ne që nuk i kemi



tryezës së paralajmëruara të partive politike, në të cilën partitë politike do të mund të gjenin ndonjë konsensus për çështjen e presidentit. Ndërsa LV-ja ka bërë me dije se presidenti duhet të zgjidhet vetëm pas zgjedhjeve të reja.

**Hoti: T'i japim drejtim zgjedhjes së presidentit apo shkuarjes në zgjedhje**

Edhe kryeministri Avdullah Hoti ka deklaruar se koalicioni qeverisës ndodhet në një situatë specifike. Ai ka thënë se duhet të vendoset për presidentin apo zgjedhjet e reja. Hoti ka treguar edhe nëse çështja e dialogut në Bruksel mund të ndikojë në prishjen e koalicionit qeverisës. "Nuk besoj se duhet të jetë problematike kjo çështje, sepse po zhvillohet mbi parimet e qarta. Nuk mund të bëhet molla shërri asnjëherë, sepse ne kemi një program qeverisës dhe po vazhdojmë të punojmë në bazë të atij programi. Tash jemi në një situatë specifike, ku duhet t'u japim drejtim çështjeve të zgjedhjes së presidentit, apo shkuarjes në zgjedhje. Unë besoj se në ditët e ardhshme spektri politik do të arrijmë t'i koordinojmë këto aktivitete për të gjetur zgjidhje më të mirë për vendin", ka thënë Hoti. Ai ka deklaruar se vazhdimi i procesit të dialogut me Serbinë po bëhet për interesa të Kosovës. "Unë vlerësoj dhe jam i bindur se vazhdimi i procesit të dialogut është në interesin më të mirë të shtetit të Kosovës. Ne në këtë proces nuk shkojmë për interesa të askujt, por shkojmë për ta mbrojtur interesin e shtetit të Kosovës. Kemi një pajtim me partnerët tanë, me BE-në, që të punohet për draftimin e marrëveshjes finale për njohjen reciproke", ka deklaruar kryeministri Hoti.

egot personale. Kushdo që kërkon votat e deputetëve të PDK-së në Kuvendin e Kosovës, duhet ta kuptojë një herë e përgjithmonë, që në atë propozim e ka brenda edhe kandidatin e PDK-së. Barrikadimi pas propozimeve individuale, ende pa filluar një diskutim politik ndërmjet partive parlamentare, është i dëmshëm dhe nuk e ndihmon tejkalimin e krizës, por vetëm thellimin e saj", ka bërë me dije Hoxhaj. Duke i parë këto qëndrime, LDK-ja ka përmendur mundësinë e dështimit të

# Edhe 13 të vdekur dhe 562 raste të reja me Covid në Kosovë

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), janë testuar gjithsej 1 595 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 562 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga: Prishtinë tri raste (83, 77, 68 vjeç), Mitrovicë dy raste (77, 60 vjeç), Viti një rast (60 vjeç), Klinë një rast (75 vjeç), Obiliq një rast (76 vjeç), Kamenicë një rast (72 vjeç), Gjakovë një rast (85 vjeç), Vushtrri një rast (64 vjeç), Prizren një rast (51 vjeç), Rahovec një rast (77 vjeç)

Numri total i rasteve pozitive është 45 004 raste nga 158 577 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 161 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 761 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 31 802 raste, ndërsa

numri i rasteve aktive është 12 041.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 223 raste, Podujevë 47 raste, Mitrovicë 39 raste, Pejë 33 raste, Gjakovë 28 raste, Fushë-Kosovë 27 raste, Lipjan 22 raste, Prizren 22 raste, Istog 16 raste, Vushtrri 13 raste, Suharekë 12 raste, Drenas 11 raste, Obiliq 11 raste, Klinë 9 raste, Malishevë 9 raste, Ferizaj 7 raste, Deçan 6 raste, Rahovec 6 raste, Skenderaj 5 raste, Dragash 3 raste, Shtime 3 raste, Gjilan 2 raste, Zveçan 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Graçanicë, Junik, Kamenicë, Kaçanik, Viti dhe Zubin-Potok.



## Hoxhaj pret në takim shefin e EULEX-it, diskutojnë për Gjykatën Speciale

**PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER)** - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, së bashku me anëtarin e kryesisë, Elmi Reçica, kanë pritur të enjten në takim shefin e Misionit të EULEX-it, Lars-Gunnar Wiegemark. Në këtë takim kryetari Hoxhaj ka folur me shefin e EULEX-it për Gjykatën Speciale dhe zhvillimet aktuale politike në vend. Shef i Misionit të EULEX-it, Lars-Gunnar Wiegemark, ka folur edhe për punën që bën EULEX-i për monitorimin e gjyqësorit në Kosovë.

Ndërkohë, Hoxhaj ka folur për qasjen konstruktive të Partisë



Demokratike të Kosovës, e cila, edhe pse në opozitë, sipas tij,

është gjithmonë e gatshme ta japë kontributin në të mirë të

shtetit dhe të qytetarëve, siç ishte rasti i fundit me votimin e pakos

së rimëkëmbjes ekonomike.

Po ashtu, dialogu Kosovë - Serbi, si një proces i cili ka çaluar shumë vitin e fundit, ishte një tjetër temë për të cilën u diskutua. Edhe gjatë kësaj teme kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës kërkoi që Serbisë t'i bëhet akoma më shumë presion në lidhje me zbardhjen e fatit të të pagjeturve në Kosovë, trupat e të cilëve po zbulohen edhe sot e kësaj dite atje.

Në fund, kryetari në detyrë, Enver Hoxhaj, ka përsëritur qëndrimin e PDK-së për konstruktivitet të plotë me të gjithë ata të cilët punojnë në të mirë të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

## OBI u bënë thirrje vendeve anëtare ta njohin pavarësinë e Kosovës

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka përshëndetur dhe mirëpritur miratimin e rezolutës për Kosovën të Këshillit të Ministrave të Organizatës për Bashkëpunim Islamik (OBI), në sesionin e 47-të të saj, mbajtur në Niamey, kryeqytetin e Nigerit. Përmes kësaj rezolute shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Islamik u bëjnë thirrje vendeve anëtare, të cilat nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, që të veprojnë për njohjen e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, duke shtuar se kjo do t'i shërbente paqes në rajon dhe më gjerë. Në rezolutë, përpos të tjerash,

nënvizohen të arriturat e Republikës së Kosovës për fuqizimin e demokracisë dhe për ndërtimin e institucioneve funksionale. Po ashtu, në rezolutë përmendet stabiliteti në vend, respektimi i të drejtave të njeriut sipas standardeve më të larta ndërkombëtare të cilat janë të mishëruar në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Organizata për Bashkëpunim Islamik, gjithashtu, mirëpret bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me institucionet ekonomike dhe financiare të Organizatës për Bashkëpunim Islamik, ndërsa u bënë thirrje vendeve anëtare të saj të kontribuojnë për zhvillimin ekonomik të Kosovës.



## Selimi dhe Çoçaj diskutojnë për rishikimin funksional të sundimit të ligjit



PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selimi Selimi, të enjten ka takuar kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skender Çoçaj, me të cilin ka diskutuar rreth finalizimit të rekomandimeve të cilat duhet të përfshihen në strategjinë e cila del nga procesi i rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Ministri Selimi gjatë bashkëbisedimit me kryesuesin Çoçaj ka theksuar se roli i Këshillit Gjyqësor të

Kosovës është i rëndësishëm së veçantë, pasi që përmes procesit të rishikimit funksional do të adresohen edhe sfidat e sistemit gjyqësor.

Ministri Selimi ka thënë se koordinimi institucional bën politikën e rishikimit të implementueshme dhe nuk lejon ndërmarrjen e politikave të njëanshme.

Selimi, po ashtu, ka falënderuar kryesuesin Çoçaj për bashkëpunimin e deritanishëm,

duke shtuar se KGJK mbetet hallkë e rëndësishme për sistemin e drejtësisë dhe për zbatimin e reformave të ndërmarra me qëllim të forcimit të sundimit të rendit dhe ligjit. Nga ana tjetër, kryesuesi Çoçaj ka falënderuar ministrin Selimi për bashkëpunimin e ofruar dhe ka konsideruar se rishikimi funksional është një prej proceseve më të mëdha të cilat mund të zgjidhë shumë probleme që hasen në sistem.

## Zëvendëskryeministri Tahiri: Flakron Shala kishte përgatitjet e duhura për konsull

Prishtinë, 10 dhjetor - Çështja e emërimit konsull e Flakron Shalës, djalit të deputetit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Haxhi Shala, është kthyer të enjten në çështje diskutimi në Kuvendin e Kosovës. Kjo çështje u ngrit në seancën e Kuvendit të Kosovës nga deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli. Ajo u është drejtuar me një pyetje përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës, nëse emërimi i Shalës ka qenë "pazar politik" për votimin e qeverisë nga ana e deputetit Haxhi Shala. Në emër të qeverisë për këtë çështje u përgjigj zëvendëskryeministri Besnik Tahiri, i cili tha se rasti apo personi në fjalë [Flakron Shala] ka përgatitjet e duhura akademike. "Ai i ka përcjellë të gjitha procedurat dhe, fatmirësisht apo fatkeqësisht, ka qëlluar [rastisur] të jetë djali i Haxhi Shalës", ka thënë Tahiri, duke shtuar se "nuk është gjë e duhur që me një diskurs të tillë të sulmohen fëmijët e politikanëve". Kurse ministrja e Punëve të



Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë se nuk ka as nuk do të ketë nënshkrim të saj në vendime të cilat janë të jashtëligjshme. "Secili emërim i konsujve të përgjithshëm, edhe këtë vit, si të gjitha vitet paraprake prej kur ekziston Ministria e Punëve të Jashtme, është propozuar në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjet, si dhe praktikën e deritanishme 12-vjeçare", ka thënë ajo.

Më 25 nëntor ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa

Osmani, ka shfuqizuar katër dekrete për konsuj të përgjithshëm, konkretisht për konsujt në Pragë, Lubjanë, Shkup dhe Tiranë.

Dekretet ishin nënshkruar nga ish-presidenti Hashim Thaçi. Osmani e ka marrë këtë vendim pasi mediati lokale kanë raportuar për emërimin e Flakron Shalës konsull i përgjithshëm në Pragë. Rikujtojmë se vota e Haxhi Shalës ka qenë vendimtare për votimin e qeverisë aktuale të drejtuar nga Avdullah Hoti.

Gjatë seancës së Kuvendit të

Kosovës, kur është votuar për qeverinë e re, deputeti Shala pati deklaruar se ai ka ndryshuar mendimin për ta votuar qeverinë, pasi një natë më parë kishte takuar ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, dhe kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. Emërimi i Flakron Shalës në këtë pozitë ishte kundërshtuar edhe nga shoqëria civile në Kosovë. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, pati thënë se emërimi i Shalës ishte bërë pa pasur një koordinim me të.

Ndërsa vetë Flakron Shala përmes një postimi në rrjetet sociale ka thënë se në pozitën e konsullit të përgjithshëm është "emëruar sipas ligjit në fuqi". "Prindi im, Haxhi Shala, si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk ka as më shumë e as më pak autoritet ligjor e politik se deputetët e tjerë. Pra, deputeti nuk ka kompetencë t'i emërojë apo shkarkojë zyrtarët e MPJ-së dhe as konsujt e PËRGJITHSHEM", ka shkruar Shala.

Të shkarkuarit e tjerë janë: Blendi Kilaj (Lubjanë), Lindon Kqira (Shkup) dhe Halim Krasniqi (Tiranë). Blendi Kilaj është djali i Isni Kilajt, ish-zëvendësministër i Financave në Kosovë dhe zyrtar i Partisë Demokratike të Kosovës. Mes të tjerash, Osmani është zotuar se do të vazhdojë të insistojë, që të mos tejkalohet kuota e emërimeve politike, e paraparë me Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, dhe që emërimet të bëhen nga radhët e diplomatëve të karrierës.

# Duhet bashkëpunim më i mirë në mes të Kuvendit dhe qeverisë

Instituti Demokracia për Zhvillim ka mbajtur të enjten një konferencë në të cilën ka bërë publik lansimin e punimit "Analizë mbi veprimtarinë e Kuvendit të Kosovës në periudhën 2019-2020". Gjatë kësaj konference nga panelistët u diskutua mbi çështje të cilat janë paraqitur edhe në raport siç janë: mosprania e deputetëve në seanca parlamentare, gjuha joparlamentare dhe të tjera, duke u arsyetuar se mungon vullneti politik për të përkrahur çështje të caktuara



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Instituti Demokracia për Zhvillim ka organizuar të enjten konferencën për lansimin e punimit "Analizë mbi veprimtarinë e Kuvendit të Kosovës në periudhën 2019-2020". Pjesë e panelit në këtë konferencë ishin nënkryetarja e Kuvendit Arbërie Nagavci, deputetët Shkëmb Manaj dhe Blerta Deliu-Kodra, ndërsa punimi është prezantuar nga autori Albert Krasniqi. Në këtë punim janë mbledhur dhe analizuar të dhënat se si Kuvendi i Kosovës ka përbushur rolin

për mbikëqyrjen parlamentare dhe shqyrtimin e legjislacionit. Në raport fokus është periudha nga janari i vitit 2019 deri në gusht i vitit 2020, që përfshinë dy sesionet e punës së dy legjislaturave të ndryshme. Ndërmjet kësaj periudhe është bërë edhe ndryshimi i legjislaturës nga e gjashta në të shtatën, ku për mbi tre muaj Kuvendi ka pushuar aktivitetet për shkak të zgjedhjeve të parakohshme. Ky raport mund t'u shërbejë qytetarëve që të kuptojnë se si punon Kuvendi, deputetëve që të kenë një vlerësim objektiv të punës së tyre, në mënyrë që t'i ndërmarin reformat e

nevojshme për ta rritur funksionalitetin e këtij institucioni. Një nga gjetjet e punimit është se legjislatura e gjashtë e Kuvendit, përkundër mungesës së qartë të shumicës parlamentare, ka qenë më efikase për shqyrtimin e ligjeve, madje duke miratuar disa prej ligjeve që për kohë të gjatë kanë qëndruar në sirtarët e qeverisë dhe që kanë kërkuar konsensus më të gjerë.

Gjatë kësaj konference nga panelistët u diskutua mbi

çështje të cilat janë paraqitur edhe në raport siç janë: mosprania e deputetëve në seanca parlamentare, gjuha joparlamentare dhe të tjera duke u arsyetuar se mungon vullneti politik për të përkrahur çështje të caktuara. Ndërkaq për t'i adresuar të gjitha sfidat e identifikuar, shihet i nevojshëm miratimi i rregullores së re.

Nga të pranishmit u potencua se Kuvendi ka ushtruar mandatin e tij në rrethana jonormale për shkak të pandemisë Covid-19,

andaj ka qenë e vështirë të nxirren krahasime të punës së Kuvendit duke pasur parasysh këto rrethana. Ndër të tjera, u diskutua se nevojitet një koordinim më efikas në mes të Kuvendit dhe qeverisë në mënyrë që deputetët të arrijnë t'i përbushin obligimet e tyre. Sa i përket transparencës dhe llogaridhënies, nga panelistët u theksua se janë qytetarët ata të cilët duhet të vlerësojnë sa janë të përgjegjshëm deputetët duke votuar apo mosvotuar për ta në legjislacionin e ardhshëm.

# Kosova me dokument strategjik për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Në takimin e Grupit Ndërmintor për të Drejtat e Njeriut, kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se qeveria është plotësisht e përkushtuar dhe e angazhuar që të drejtat e njeriut të jenë të përfaqësuara si pjesë e vlerave të shtetit tonë, duke u bazuar në parimet elementare të demokracisë, të sundimit të ligjit, të mosdiskriminimit, të promovimit të barazisë gjinore, të bashkëjetesës sonë paqësore dhe të respektit reciprok midis të gjitha grupeve të popullsisë, pavarësisht prej ndryshimeve që mund të kemi në baza gjuhësore, etnike, kulturore, fetare ose çfarëdo baze tjetër.

Duke folur për programin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës për periudhën 2021-2025, kryeministri Hoti tha se ky dokument strategjik parashihet të jetë një katalizator në këtë fushë, ku përcaktohen hapat konkretë që duhet të ndërmerren për të ndërtuar një strukturë që është koherente për promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut

dhe pastaj të ndikojë për shpejtimin e investimeve të nevojshme në këtë fushë, në mënyrë që të drejtat e njeriut të konsiderohen dhe të mbrohen në çdo aspekt, para së gjithash, duke ndikuar në fuqizimin ekonomik të secilit qytetar pavarësisht prej dallimeve. "Gjithashtu, sot do t'i paraqesim të gjeturat e hulumtimit mbi promovimin e diversitetit dhe barazisë në Kosovë. Ky dokument pasqyron të dhënat mbi situatën sa i përket gjendjes në këtë fushë, njëkohësisht identifikon sfidat të cilat ne duhet t'i adresojmë duke zhvilluar politika adekuate, por edhe veprime institucionale konform nevojave të paraqitura. Për më tepër, bazuar në parimin e mbrojtjes nga diskriminimi edhe me qëllim të zhvillimit të një ambienti të punës të sigurt dhe të paanshëm, profesional dhe të përgjegjshëm në institucionet e Republikës së Kosovës. Ne kemi miratuar, siç e kemi parë para disa dite, politikën kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike të Republikës së Kosovës, me qëllim që kjo politikë të shërbejë si një udhëzues për parandalimin e çfarëdo forme të ngacmimit seksual që mund ta



cenojnë dinjitetin personal të secilit të punësuar në organet e Administratës Publike", ka thënë Hoti, duke shtuar se, po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se me vendimin 138/2020 është themeluar grupi teknik për mbrojtje nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, i cili mekanizëm ka

përkrahjen e plotë të qeverisë dhe të institucioneve përkatëse për t'i adresuar të gjitha çështjet, të gjitha ankesat që mund të vijnë nga ky komunitet lidhur me diskriminimin ndaj tyre. "Pra, angazhimi ynë i vazhdueshëm ka qenë krijimi i mundësive të barabarta, respektimi i diversitetit shoqëror, mbi bazën e të cilit

mund të krijojmë së bashku një shoqëri të shëndoshë dhe të mirëfilltë. Si rrjedhojë, të gjitha institucionet përgjegjëse në këtë mekanizëm do t'i paraqesin në vazhdim veprimet e ndërmarra që përbushin standardet sa iu përket të drejtave, respektimit të të drejtave të njeriut në vend", ka deklaruar kryeministri Hoti.



Ibrahim Berisha (RFE/RL)

# TË PABARABARTË PARA LIGJIT

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, i cili qytetarëve të Kosovës iu mundëson tërheqjen e 10 për qind të kursimeve pensionale, i vë në pozitë të pabarabartë qytetarët dhe rrjedhimisht mund të ketë elemente që të trajtohen edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, thotë profesori i çështjeve juridike kushtetuese, Mazllum Baraliu.

Neni 5 i këtij ligji, që është miratuar më 4 dhjetor në Kuvendin e Kosovës, parasheh që Qeveria e Kosovës t'i kompensojë qytetarët që tërheqin mjete, e të cilët kanë kursime deri në 9 999 euro. Kurse ata që kanë mbi 10 mijë euro, nuk do të rimburohen. Për këtë, Baraliu thekson se në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit. "Është diçka që thjesht mund të jetë diskutabile dhe rrjedhimisht mund të jetë edhe objekt i trajtimit me ndonjë parashtrësë nga ato subjekte që, sipas Kushtetutës, kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese", tha Baraliu. Në bazë të të dhënave të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, 92 për qind e kontributpaguesve në llogaritë e tyre kanë nën 10 mijë euro, kurse vetëm 8 për qind mbi 10 mijë euro.

## Rukiqi: Mosrimburësimi për një pjesë të kontributpaguesve është diskriminues

Edhe Berat Rukiqi, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, i cili ka mirëpritur miratimin e këtij ligji, thotë se nuk pajtohet vetëm me nenin ku ka të bëjë me kompensimin e kursimeve të kontributpaguesve deri në 10 mijë euro. Sipas tij, ky veprim është diskriminues. "Është diskriminim. Ose duhet të kompensohen të gjithë ose nuk duhet të kompensohet asnjë. Realisht kjo mund të jetë çështje për Gjykatën Kushtetuese sepse shkel të drejtat e kontributpaguesve të tjerë", thekson Rukiqi për "Radion Evropa e Lirë". Çdo trajtim jo i barabartë përbën shkelje të të drejtave të njeriut, thotë Behxhet Shala nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë. Por, në situatën në të cilën gjendet vendi për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi, Shala e arsyeton veprimin e Qeverisë së Kosovës në mënyrë, siç thotë ai, t'i ndihmojë rastet që kanë më pak mjete të kursyera në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Ai vlerëson se personat që kanë nën 10 mijë euro edhe kushtet materiale i kanë më të

rënda. "Në një situatë emergjente në të cilën jemi, në një situatë të vështirësuar ekonomike për vendin, besoj se është obligim i qeverisë të kujdeset fillimisht për kategoritë e rrezikuara. Mendoj se këta që kanë mbi 10 mijë euro kursime nuk do të duhej të kundërshtonin në këtë fazë këtë çështje, pasi në ndihmë duhet t'u dilet kategorive më të rrezikuara që kanë më pak se 10 mijë euro kursime. Kurse në të ardhmen, sipas mundësive, duhet të shikohet për rimburesim të mjeteve edhe të kontributpaguesve që kanë mbi 10 mijë euro", shprehet Shala.

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike është votuar në Kuvendin e Kosovës pas disa dështimesh, derisa ka marrë mbështetjen edhe të partisë opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës. Ligjin nuk e kanë përkrahur deputetët e Lëvizjes Vetëvendosjes. Hekuran Murati, deputet i Lëvizjes Vetëvendosjes, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ky nen krijon dhe thëllon edhe më tepër pabarazinë sociale në mes të qytetarëve. Megjithatë, ai thotë se nuk është diskutuar që ligji të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. "Një gjë e tillë është kundërkushtetuese dhe

krijon dhe thëllon pabarazi sepse nuk e përcakton niveli i kursimeve në Trust nivelin e pasurisë apo nivelin e statusit material që mund të ketë dikush", thekson ai.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, tha se nëse ka iniciativa të tilla për dërgimin e ligjit në Gjykatën Kushtetuese, duhet të mblidhen institucionet përkatëse dhe ta trajtojnë këtë çështje. "Duhet të shohim se nëse kompensimi duhet të trajtohet si pabarazi sociale, atëherë duhet të mblidhen institucionet për të trajtuar këtë çështje", tha Bajrami në një konferencë për media, së bashku me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti dhe përfaqësues të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, më 11 dhjetor 2020 do të fillojë aplikimi i kontributpaguesve për të tërhequr 10 për qind të kursimeve pensionale, ka njoftuar të martën kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti. Por, Sadri Ferati, rreth 45 vjeç, i cili ka punuar herë pas herë në sektorin privat dhe në llogarinë e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, ka rreth 200 euro, thotë se nuk do të tërheqë 10 për qind të mjeteve të përgjithshme, që i bie 20 euro.

"Për çfarë arsye qeveria nuk ka qenë në gjendje t'i klasifikojë, për shembull, kategoritë. Ata që kanë deri në 500 euro t'u jepen të gjitha mjetet, në mënyrë që të përfitojnë diçka. Nga ky ligj ka përfituar vetëm kategoria e pasur. Qytetarët që kanë deri nën 10 mijë euro, mjetet do t'u rimburohen, kurse ata që kanë mbi 10 mijë edhe nuk kanë nevojë për mjete të Trustit", tha Ferati.

Bukurie Berisha që 12 vjet punon në sektorin privat. Ajo thotë se asnjëherë nuk është interesuar për t'u njoftuar për shumën e mjeteve, por është e interesuar që t'i tërheqë ato kur të nisë aplikimi. "Ide shumë pozitive sepse dihet standardi i popullit tonë dhe kjo do të jetë ndihmë edhe për buxhetin tim familjar", thotë Berisha.

Kurse Arbër Ademi, student i ekonomisë, në një nga kolegjet private në Kosovë, i cili ka filluar punën në një lokal në Prishtinë që gjashtë muaj, thotë se nuk ka shumë para për të tërhequr dhe as nuk do të aplikojë. Por, megjithatë, ai e vlerëson si të padrejtë vendimin e qeverisë që një kategori të kontributpaguesve t'u kthehet mjetet në llogaritë e tyre, e të tjerëve jo. "Duhet që të gjithëve t'u rimburohen paratë sepse është e padrejtë që dikush që ka 9.999 euro të kompensohet, kurse tjetri 10.010 euro të mos i kthehen (paratë). Kjo për mua është e padrejtë", tha ai. Numri i kontributpaguesve në Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës ka arritur në 639.264, kurse vlera e mjeteve në menaxhim është mbi 2 miliardë euro. Fondi ka njoftuar se aplikimi për tërheqjen e 10 për qind të kursimeve nga kontributdhënësit mund të bëhet vetëm në formë elektronike, përmes një faqeje të veçantë interneti.



# Bëhet thirrje që bizneset t'i raportojnë rastet e korrupsionit

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Si aktivitet pasues i publikimit të Studimit mbi Perceptimin e Korrupsionit, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në bashkëpunim me programin e USAID-it për drejtësi komerciale, organizoi një forum virtual lidhur me rolin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit, gjatë të cilit u diskutuan të gjeturat nga studimi, me theks të veçantë tek ato që lidhen me raportimin e korrupsionit, derisa u bisedua edhe mbi rolin e digjitalizimit të prokurimit publik si dhe

ndikimin e këtij procesi në luftën kundër korrupsionit. Shaip Havolli, drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka theksuar se ky institucion ka përmbushur objektivat e parapara për këtë vit kalendarik, duke u ardhur në ndihmë të gjitha palëve që kanë paraqitur ankesa apo raste të korrupsionit, ku përmendi 79 raste të trajtuara deri më tani. Më tutje, duke u ndërlidhur me të gjeturat e studimit mbi perceptimin e korrupsionit në vend, Havolli i cilësoi të njëjtat si informata mjaft të nevojshme, derisa përmendi edhe hezitimin nga ana e bizneseve për raportim të korrupsionit si

rrjedhojë e frikës nga hakmarrja, por në raste të shpeshta edhe për shkak të përfshirjes së vetë bizneseve në korrupsion. Megjithatë, sipas Havollit, korniza ligjore që rregullon veprimtaritë e bizneseve, e që tashmë përfshin edhe Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, siguron mbrojtje ligjore të personave që raportojnë korrupsionin duke krijuar lehtësira në këtë drejtim. Për më tepër, ai foli edhe për prokurimin publik, i cili i është nënshtruar proceseve të digjitalizimit, gjë që ka pasur ndikim pozitiv në rritjen e transparencës dhe ka minimizuar mundësitë për

korrupsion.

Artan Canhasi, udhëheqës i komponentit dhe specialist për fuqizimin e shoqërisë civile, në programin e USAID-it për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse, i cilësoi si shumë relevante dhe të vërteta të gjeturat e studimit për perceptimin e korrupsionit, ndërsa shtoi se periudha e pandemisë Covid-19 dhe reformat e implementuara në veprimtaritë si prokurorimi publik kanë pasur ndikim pozitiv në uljen e nivelit të korrupsionit në nivel komunal dhe rritje të transparencës sa iu përket proceseve të tenderimit, të cilat pranojnë një numër të lartë të

aplikantëve, gjë që krijon vështirësi në trajtim të mirëfilltë të tyre.

Canhasi, gjithashtu, përmendi edhe nevojën për rritje të njohurive rreth digjitalizimit të prokurimit publik dhe rritje të bashkëpunimit në mes të institucioneve të përfshira në procedurat si ato të përzgjedhjes së tenderëve, ndërsa theks të veçantë i dha edhe nevojës për unifikim të komunitetit të bizneseve që bashkërisht duhet ta ngrehë zërin kundër korrupsionit.

Canhasi u bëri thirrje bizneseve t'i raportojnë rastet e korrupsionit dhe të kenë besim në institucione shtetërore.



## Mbillen 150 drunj në kryqëzimin e autoudhëve 'Ibrahim Rugova' dhe 'Arbën Xhaferi'

PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Në kuadër të memorandumit në mes të Ministrisë së Infrastrukturës, organizatës "Ta Pastrojmë Kosovën" dhe Komitetit Olimpik të Kosovës janë mbjellë 150 drunj në kryqëzimin e autoudhëve "Ibrahim Rugova" dhe "Arbën Xhaferi". Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka thënë se kjo iniciativë ndikon në ruajtjen e ambientit, njëkohësisht do t'i vetëdijesojë të gjithë qytetarët që të kujdesen më shumë për ambientin. "Ky aktivitet ka disa qëllime, përpos ruajtjes së

ambientit, ndikon edhe në ruajtjen e rrugës dhe besoj se mbjellja e drunjve e ka efektin e mbrojtjes të brezit rrugor. Sot kemi filluar simbolikisht dhe besoj se do të ketë impakt pozitiv. Po ashtu, kjo do të shërbejë si vetëdijesim për të gjithë qytetarët që të jenë më të vëmendshëm për ruajtjen e ambientit. Mbajllja do të vazhdojë nëpër autoudhët e Kosovës, rrugët nacionale dhe rajonale, duke ndikuar në përmirësimin e ambientit dhe zbukurimin e rrugëve", ka thënë Abrashi. Ndërsa drejtori i organizatës "Ta

pastrojmë Kosovën", Luan Hasanaj, ka theksuar se mbjellja e drunjve ka impakt të madh në mjedis sepse, sipas tij, ka shumë probleme me ndotjen e ajrit, sidomos në Prishtinë. "Projekti do të vazhdojë për dhjetë vjetet e ardhshëm dhe shpresojmë që në përfundim Kosovës t'ia kthejmë pamjen e merituar", është shprehur Hasanaj. Mbajllja e drunjve është në kuadër të fushatës "T'i japim vendit ngjyra", ku parashihet për dhjetë vjet të mbillen 1.8 milion drunj në të gjithë vendin, e që pjesë e kësaj initiative është edhe Ministria e Infrastrukturës.



## 50 euro për të infektuarit me Covid-19 në Kamenicë

KAMENICË, 10 DHJETOR (ER) - Komuna e Kamenicës ka njoftuar qytetarët e saj për kushtet që duhet t'i plotësojnë dhe procedurat për të aplikuar për subvencionin në vlerë prej 50 eurosh për personat e infektuar me Covid-19. Në njoftim thuhet se personi që aplikon duhet të jetë në listën

e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Po ashtu, për të qenë përfitues i këtij subvencioni duhet që qytetarët ta dërgojnë konfirmimin e xhirrologarisë që merret në bankë. "Ju njoftojmë se për të aplikuar për subvencionimin në vlerë prej 50 eurosh duhet të jetë

personi i identifikuar me test PCR dhe të jeni në listën e IKShP-së. Gjithashtu, luteni të mos dërgoni kartelën bankare, por konfirmimin e xhirrologarisë të cilën fillimisht duhet ta merrni nga banka ku e keni të hapur llogarinë. Në të kundërtën, aplikimi nuk do të jetë i vlefshëm", thuhet në njoftim.



## QKMF-ja në Klinë pajiset me barna për trajtimin e Covidit



KLINË, 10 DHJETOR (ER) - Komuna e Klinës ka njoftuar se pas nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) është pajisur me barna për trajtimin e virusit Covid-19. "Nga sot të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës të cilët janë të konfirmuar me virusin Covid-

19 do të marrin trajtim falas në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë. Kjo është bërë me një planifikim të duhur buxhetor nga komuna, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve bazë të të infektuarve. Të infektuarit duhet të paraqiten në QKMF për ta marrë trajtimin e nevojshëm sipas përshkrimit të

mjekëve. Me vete duhet ta kenë edhe letërnjoftimin", ka njoftuar Komuna e Klinës. Kjo komunë ka njoftuar se me qëllim të ruajtjes së shëndetit, të familjeve dhe shoqërisë, ka bërë apel që të respektohen masat e institucioneve dhe udhëzimet e mjekëve, në mënyrë që numri i të infektuarve të jetë sa më i vogël.

## Fondacioni 'Labinot Tahiri' i dhuroi QKMF-së në Podujevë dy aparate për prodhim të oksigjenit

PODUJEVË, 10 DHJETOR (ER) - Këngëtarë dhe humanistë Labinot Tahiri ka vizituar të enjten Komunën e Podujevës, me ç'rast nga Fondacioni "Labinot Tahiri" Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë ia ka dhuruar dy aparatura për prodhimin e oksigjenit. Me rastin e

dorëzimit të donacionit, kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, e falënderoi humanistin Tahiri për aparatet e dhuruara, për të cilat tha se janë shumë të nevojshme për QKMF-në, duke pasur parasysh situatën pandemike me Covid-19 në të cilën ndodhemi.



## Aliu mbështet fushatën 'Bëhu shpresë', iniciuar nga të rinjtë ferizajas

FERIZAJ, 10 DHJETOR (ER) - Në kuadër të kampanjës "Bëhu shpresë", udhëhequr nga të rinjtë, Eris Berisha dhe Laureta Sopa, i pari i Ferizajt, Agim Aliu, i priti në takim, me ç'rast ofroi mbështetjen e plotë për këtë grup të rinjsh në nismën e tyre humanitare

për familjet dhe personat në nevojë në Komunën e Ferizajt. Si rrjedhojë e kësaj mbështetje, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka autorizuar përkrahjen me qindra pako ushqimore për këtë nismë, që

në ditët në vijim do ta nisë aksionin për t'i ndihmuar familjet në nevojë. Nisma të tilla të dobishme për komunitetin janë mbresëlënëse kur kihet parasysh se janë të rinjtë, bartësit e këtij vizioni, për t'i ndihmuar nevojtarët.



## Tri shkolla në Gjilan pajisen me inventar dhe materiale didaktike

GJILAN, 9 DHJETOR (ER) - Shkollat e Gjilanit "Nazim Hikmet", "Dëshmorët e Kombit" dhe "Sadulla Brestovci" janë pajisur me inventar dhe materiale didaktike sipas standardeve evropiane. Ky projekt u realizua në partneritet me organizatën ndërkombëtare Caritasin zviceran në Kosovë, në kuadër të projektit "Vendosja e

standardeve parashkollore të cilësisë së lartë duke përfunduar arsimin dhe shkencën". Drejtori i DKA-së, Nazim Gagica, pasi e falënderoi Caritasin zviceran në Kosovë për mbështetjen, tha se qëllimi është që të përmirësohet cilësia në nivelin e arsimit parashkollor përmes përmirësimit të shërbimeve të qëndrueshme.

## Bisedimet BE - Britani e Madhe përfundojnë pa marrëveshje

LONDËR, 10 DHJETOR - Bisedimet për raportet tregtare në mes të Bashkimit Evropian dhe Britanisë së Madhe, pas Brexitit, kanë përfunduar pa marrëveshje. Kryeministri britanik Boris Johnson zhvilloi një darkë pune me presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, në Bruksel. Një burim i tha BBC-së se ende ka "boshllëqe shumë të mëdha midis dy palëve", por bisedimet do të vazhdojnë. Burimi tha se "një vendim duhet të merret në lidhje me të ardhmen e bisedimeve" deri të dielën. Takimi zgjati rreth tre orë. Zyrtarët britanikë thonë se përparimi në një nivel politik mund të lejojë që negociatat e bllokuara midis kryenegociatorit të BE-së, Michel Barnier, dhe homologut të tij britanik, David Frost, të rinisin gjatë ditëve të ardhshme. Por, një burim i



qeverisë britanike tha se arritja e një marrëveshje mund të mos ishte e mundur para 31 dhjetorit, kur Britania përfundon daljen e saj nga

blloku dhe nuk do të jetë më e detyruar t'i ndjekë rregullat e tregtisë së BE-së. Përpara udhëtimit të tij në Bruksel, Johnson i tha

parlamentit se asnjë kryeministër britanik nuk mund t'i pranojë kërkesat për të cilat BE-ja "po insiston aktualisht", duke shtuar se vendi do të

përparojë edhe nëse nuk nënshkruan një marrëveshje tregtare me bllokun. Mosmarrëveshjet kanë vazhduar pavarësisht prej negociatave që kanë zgjatur tetë muaj midis Barnier dhe Frost. Shumë biznese janë në makth, pasi dështimi i një marrëveshjeje do të linte pa rregulluar rreth 1 trilion dollarë në tregtinë vjetore. Nëse nuk pajtohen, të dyja palët do të bëjnë biznes sipas rregullave të Organizatës Botërore të Tregtisë, që i bie se do të aplikojnë tarifa në importet e njëra-tjetrës. Vendimi për largim të Britanisë nga BE-ja ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

## Laureatët e Çmimit Nobel nderohen në mungesë

OSLO, 10 DHJETOR - Laureatët e Çmimit Nobel për vitin 2020 do të nderohen në mungesë më 10 dhjetor, përmes disa ceremonive që këtë vit organizohen ndryshe për shkak të pandemisë së koronavirusit. Përhapja e këtij virusi ka shtyrë zyrtarët e Nobelit që t'i anulojnë festat vjetore në Oslo, ku prezantohet Çmimi vjetor i Nobelit dhe në Stokholm ku ndahen çmimet për mjekësi, fizikë, kimë, letërsi dhe ekonomi. Organizata Botërore për Ushqim pritet ta pranojë Çmimin Nobel

për Paqe në një ceremoni në Romë. Kjo agjenci e Kombeve të Bashkuara është shpërblyer nga Komiteti Norvegjez i Nobelit për "përpjekjet për ta parandaluar shfrytëzimin e urisë si armë për luftë dhe konflikt". Në Oslo, kryeqytetin e Norvegjisë, udhëheqësja e Komitetit Norvegjez e Nobelit, Berit Reiss-Andersen, do të mbajë një fjalim online nga Instituti i Nobelit. Më vonë, gjatë ditës, në kryeqytetin suedez do të transmetohet një ceremoni përmes televizionit, në të cilën do

të publikohen disa klipe që shfaqin laureatët duke pranuar çmimet nëpër vendlindjet e tyre. Kjo është hera e parë nga Lufta e Dytë Botërore që anulohen festimet në Stokholm. Përndryshe, fituesit e çmimeve Nobel janë bërë publikë në muajin tetor. Çmimet tradicionalisht prezantohen më 10 dhjetor, përvjetorin e vdekjes së themeluesit të këtij çmimi, Alfred Nobel. Nobel, shkencëtar suedez dhe filantrop, ka vdekur më 1896.



## Kina vendos sanksione reciproke ndaj zyrtarëve amerikanë



PEKIN, 10 DHJETOR - Kina ka vendosur sanksione ndaj zyrtarëve amerikanë, përfshirë edhe zyrtarë të kongresit dhe organizatat joqeveritare, në përgjigje të sanksioneve të Uashingtonit ndaj zyrtarëve kinezë. Zëdhënësi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kinës, Hua Chunying, përderisa njoftoi sanksionet, tha se sanksionet

mbulojnë zyrtarë amerikanë në kongres, përfaqësues të OJQ-ve dhe zyrtarë të tjerë së bashku me anëtarët e familjeve të tyre "që kanë bërë gabime në çështjen e Hong Kongut", njoftoi "Global Times". Qeveria kineze, gjithashtu, anuloi hyrjen pa viza për diplomatët amerikanë të cilët mbajnë pasaporta të vlefshme në rajonin administrativ special

të Kinës në Hong Kong dhe Makao. Të hënën Uashingtoni vendosi sanksione ndaj 14 individëve, të gjithë nënkryetarë të Komitetit të Përhershëm të Kongresit Popullor 13 (NPC), për shtypjen e Pekinit në Hong Kong pasi Kina pezulloi në mënyrë efektive ligjvënësit pro-demokracisë nga legjislatura e territorit gjysmautonom muajin e kaluar.

## Restorantet në Londër do ta festojnë Vitin e Ri dy orë më herët

LONDËR, 10 DHJETOR - Në kryeqytetin e Britanisë së Madhe, Londër, festimet e Vitit të Ri do të priten ndryshe duke nisur në orën 10:00 të mëngjesit të datës 31 dhjetor, ku do të përfitojnë restorantet dhe hotelet në përpjekje për t'i

joshur klientët që t'i mposhtin kufizimet e koronavirusit. Industria e bizneseve po pret një lajmërim nga Boris Johnson për vendimin e kufizimeve të Londrës, ku mendohet për një kufizim drakonian të Nivelit të 3 që do të thotë se çdo festim

do të mbyllet. Gjithashtu, kjo vjen pasi transporti për në Londër njoftoi se nuk do të ofronte transport falas në prag të Vitit të Ri, por kryetari i komunës, Sadiq Khan, përpiket t'i ndalojë festuesit që festojnë Vitin e Ri.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# Ballkani u rikthehet fitoreve, Llapi mposhti Arbërinë



Ballkani i Ismet Munishit u është kthyer fitoreve, pasi të enjten në Suharekë ka gjunjëzuar Trepçën '89. Tri pikë ka rrëmbyer edhe Llapi në përballje me Arbërinë. Llapjanët kanë filluar t'i ikin fundit të tabelës, pasi tashmë kanë grumbulluar 17 pikë

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Skuadra e Ballkanit u është rikthyer fitoreve në Superligë, pasi të enjten ka mposhtur Trepçën '89 (2-0). Suharekasit nuk humbën shumë kohë për t'u këndellur, pasi një xhiro pas humbjes në derbi nga Drita dhe humbjes së kreut të tabelës, arriti që t'i marrë tri pikë dhe të mos lejojë shkëputjen e Dritës. "Më pëlqeu skuadra, pasi që luajti me përgjegjësi të madhe. Kemi pasur përballë vetës një kundërshtar mjaft të vështirë, mirëpo futbollistët zbatuan detyrat në përpikëri dhe triumfuan në fund me plot meritë", ka thënë Ismet Munishi.

Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0, ani pse rastet nuk munguan. Në pjesën e dytë Ballkani ishte skuadër me këmbëngulëse dhe në minutën e 62-të e zhbllkoi rezultatit nëpërmjet Edvin Kuç, i cili shënoi për 1-0. Golin e dytë dhe të fundit në ndeshje e realizoi Gripshi në minutat shtesë. Ballkani është në vendin e dytë me 38 pikë, një pikë me pak se

skuadra lidere, Drita. Trepça '89 pozicionohet e shtata në tabelë me 20 pikë.

Trajneri i Trepçës '89, Shpëtim Idrizi, pas ndeshjes deklaroi: "E kemi ditur që do të jetë një përballje e vështirë ndaj Ballkanit por, pavarësisht kësaj, ne treguam lojë shumë të pjekur. Ndoshta lëndimi i Kaçarit na vështirësoi punët, pasi që u prish struktura e lojës, sidomos në pjesën defansive. Pësuam dy gola nga pakujdesia jonë, mirëpo jam i kënaqur me atë se çfarë treguan futbollistët në fushën e lojës dhe është mëkat që nuk morëm të paktën një pikë".

Të enjten është zhvilluar edhe një ndeshje tjetër në elitën e futbollit të Kosovës, ku skuadra e Llapit e mposhti Arbërinë me rezultat 2-0. Pas tridhjetë minutash lojë, Elvis Prençi e kaloi në epërsi skuadrën mysafire. Kastriot Selmani në fund të pjesës së parë realizoi golin e dytë për skuadrën që drejtohet nga Tahir Batatina. Në pjesën e dytë Arbëria realizoi golin e parë nëpërmjet Labinot Ibrahimit, po kjo ishte e tëra që e arriti në këtë ndeshje. Pas tri pikëve të

marra, Llapi ngrehet në kuotën e 17 pikëve dhe zë vendin e parafundit, ndërsa Arbëria është e gjashta me 20 pikë.

SUPERLIGA		
Ballkani - Trepça '89	2-0	
Arbëria - Llapi	1-2	
Gjilani - Prishtina	0-3	
Drenica - Drita	0-3	
Feronikeli - Besa	3-0	
Tabela		
1. Drita	16	39 pikë
2. Ballkani	16	38
3. Prishtina	16	28
4. Feronikeli	17	23
5. Gjilani	16	23
6. Arbëria	17	20
7. Trepça '89	17	20
8. Drenica	17	18
9. Llapi	17	17
10. Besa	17	6
Në xhiron e radhës: Besa-Gjilani, Prishtina-Ballkani, Llapi-Feronikeli, Drita-Arbëria, Trepça '89-Gjilani.		

## SHKURT

### Berisha, MVP i javës së 6-të

Dardan Berisha ka qenë basketbollisti më i dalluar i javës së gjashtë në Prince Caffè Superligë. Berisha në derbin e kësaj xhiro ndaj Golden Eagle Yllit shënoi 29 pikë, kishte edhe tetë kërcime e tri asistime, me një indeks prej 24. Kapiteni i Kosovës po vazhdon me formë të mirë, pasi formë të mirë tregoi edhe ndaj Bashkimit e Rahovecit. Ai ka ndihmuar skuadrën e tij këtë edicion, ku Peja ka regjistruar gjashtë fitore në gjashtë ndeshje. Ndërkohë, top pesë shënuesit e kësaj xhiro janë Dardan Berisha i Pejës me 29 pikë, Arti Hajdari i Ponte Prizrenit me 28, Isaiah Traylor i Rahovecit me 25, Kalin Fisher i Trepçës me 24 dhe Nikola Vukçević i Bashkimit me 24.

### Katër ndeshje të Kupës zhvillohen në fundjavë

Është caktuar termini i ndeshjeve të rrethit të 1/16 së finales së Kupës së Kosovës. Katër ndeshje do të luhen në këtë fundjavë, derisa ndeshjet e tjera në mesjavën e ardhshme. Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 12:30. Të shtunën takohen Vitia - Ferizaj. Të dielën zhvillohen këto ndeshje Vllaznia (P) - Dukagjini, Malisheva - 2 Korriku dhe Ulpiana - Liria.

### Ozili i vetofrohet Juventusit

Ish-kampioni i botës me Gjermaninë, Mesut Ozil, i është vetofruar Juventusit. Ozili nuk është aktivizuar në asnjë takim me "topçinjtë" e Londrës duke bërë më shumë sesa një ide transferimin e turko-gjermanit në Itali te klubi bardhezi që drejtohet nga Andrea Pirlo.

### Tare dhe Inzaghi drejt Interit

Gazeta italiane "Il Messaggero" raporton se ardhmja e drejtorit sportiv të Lazios, Igli Tare, është e lidhur ngushtë me atë të trajnerit Simone Inzaghi. Ky i fundit ende nuk ka negociuar rinovimin me Lotiton, teksa shihet si një kandidat për ta marrë stolin e Interit, në rast se zikaltrit vendosin ta ndërpresin marrëveshjen e bashkëpunimit me trajnerin Conte. Të njëjtën rrugë mund ta ndjekë edhe shqiptari që mund të bëhet kështu drejtori sportiv tek Interi duke marrë vendin e Pier Ausilios, që duket pranë largimit. Ky do të ishte një hap i madh në karrierën e Tares, që është vlerësuar sezonet e fundit si një ndër drejtorët sportivë më të mirë në Itali.

## Hysaj dhe Rrahmani, sërish pozitiv me Covid-19

**NAPOLI, 10 DHJETOR** - Dy futbollistët shqiptarë të Napolit, Elseid Hysaj dhe Amir Rrahmani, kanë rezultuar sërish pozitivë me Covid-19. Edhe pse janë infektuar rreth 25 ditë më parë gjatë grumbullimeve me

“kuqezinjtë” dhe “dardanët”, Hysaj dhe Rrahmani kanë rezultuar pozitivë ndaj tamponëve që kanë kryer futbollistët e Napolit ditën e mërkurë, para sfidës ndaj Real Sociedadit. Lajmi është njoftuar nëpërmjet një postimi

në faqen zyrtare, nga klubi napolitan, ku shkruhet se 2 mbrojtësit janë ripozitivizuar dhe do të izoloohen në shtëpi, në pritje të tamponit të ri. “Të gjithë tamponët e bëra të mërkurën në mëngjes për pjesëtarët e ekipit janë

negativë për Covid-19, me përjashtim të Amir Rrahmanit dhe Elseid Hysaj, të cilët janë ripozitivizuar dhe do të izoloohen në shtëpi në pritje të përgjigjeve të një tamponi të ri”, thuhet në njoftimin e Napolit.



## Kastrioti arrin fitore të madhe ndaj Prishtinës

**FERIZAJ, 10 DHJETOR** - Ndonëse vlerësohej favorite, Prishtina ka mbetur pa pikë në ndeshjen e së mërkurës në Ferizaj, pasi pësoi humbje 41:39. Ferizajasit kanë bërë përmbyse të rezultatit në pjesën e dytë për fitoren më të madhe të këtij edicioni të Superligës së hendbollistëve. Ndeshja i takoi javës së 12-të. Pjesën e parë Prishtina e fitoi me një gol dallim, 19:18. Edhe pjesa e parë ishte e barabartë, por Prishtina shkoi në pushim me një gol epërsi. Në pjesën e dytë Prishtina startoi fuqishëm, ndërsa krijoi epërsi deri në gjashtë gola (28:22, 29:23). Por Kastrioti nuk u dorëzua. Ngadalë afro rezultatin dhe në minutën e 49 e barazoi në 31:31. Më pas u luajt për secilin gol, ndërsa Kastrioti në disa raste kishte dy gola epërsi. Në fund



rezultati ishte 41:39 në të mirë të ferizajasve. F. Mustafa ishte më efikas te Kastrioti me 11 gola. Te

Prishtina, L. Shabani e A. Bajqinovci realizuan nga 8 gola. Kastrioti është i katërti me 14 pikë, kurse Prishtina mbetet e dyta me 20 pikë. Tani Besa Famgas ka katër pikë më shumë në vend të parë. Besa Famgas pa telashe fitoi ndaj Drenicës në Drenas. Ndërkohë Trepça e mposhti Vëllaznimin në Gjakovë (22:20) dhe Vushtrria fitoi në Podujevë ndaj Llapit (33:30).

### REZULTATET

Llapi - Vushtrria	30:33 (13:15)
Kastrioti - Prishtina	41:39 (18:19)
Drenica - BesaFamgas	18:46 (9:25)
Vëllaznimi - Trepça	20:22 (12:11)

## Shuhet legjenda e futbollit italian, Paolo Rossi

Romë, 10 dhjetor - 2020-ta do të mbahet mend si një vit i zi për futbollin dhe jo vetëm. Pas dy humbjeve të rënda në pak ditë, siç ishin ndarja nga jeta e legjendës Diego Armando Maradona dhe ish-trajnerit të Argjentinës, Alejandro Sabella, një tjetër lajm shumë i dhimbshëm për futbollin, që prek shumë edhe fansat e shumë shqiptarë të Italisë është njoftuar të enjten në mëngjes nga mediat italiane. Paolo Rossi, heroi i Italisë në Botërorin e vitit 1982 në Spanjë, ka ndërruar jetë. Ish-sulmuesi i Juventusit është ndarë nga jeta në moshën 64-vjeçare për shkak të një sëmundjeje të pashërueshme. Paolo ishte hero kombëtar në Itali për shkak të atij Botërori të paharrueshëm. Ai sapo ishte kthyer nga një dënim, por u grumbullua në kombëtare dhe bëri atë, që askush nuk e mendonte. Italia nuk ishte aspak pretendente, por në fund shkoi me Kupën në shtëpi dhe protagonist i kryesor ishte padyshim Rossi. Ai i



shënoi atë tregolësh të pabesueshëm Brazilit të mbushur plot me yje dhe i shënoi Gjermanisë në finalen e fituar 3-1. Me Juven ai fitoi dy Serie A, teksa futbollit italian humbet një nga simbolet e tij. Pas tërheqjes nga futbollit Rossi u bë komentator shumë i zoti, duke punuar në televizione

gjigante si Rai, Sky dhe Mediasset. Ai la tre fëmijë, Sofia Elena, Maria Vittoria dhe Alessandro. Ishte i martuar me gruan e tij Federica, e cila njoftoi e para në rrjetet sociale ndarjen e tij nga jeta. Homazhet për Paolo Rossin priten të jenë të shumta gjatë ditës së sotme nga fansat e futbollit italian.

### SHKURT

#### Të hënën shorti i Ligës së Kampionëve

16 skuadra elitë të Ligës së Kampionëve kanë arritur që të kalojnë në fazën tjetër të garave. Kështu, shorti për fazën tjetër në Ligën e Kampionëve do të hedhet të hënën me 14 dhjetor duke filluar nga ora 12:00. Ceremonia do të mbahet në selinë e UEFA-s në Nyon të Zvicrës. Kujtojmë se ekipet nga i njëjti grup nuk mund të tërhiqen kundër njëri-tjetrit, gjithashtu nuk mund të tërhiqen klubet nga i njëjti shtet.

#### Zidane: Ishte ndeshja më e kompletuar këtë sezon

Real Madridi e mposhti Borussia Monchengladbach (2-0) dhe u kualifikua si e para në grup. Trajneri Zinedine Zidane e ka vlerësuar paraqitjen e skuadrës së tij ndaj gjermanëve si më të mirën në këtë edicion. “Synimi ishte të përfundonim në vendin e parë. Ne luajtëm në mënyrë spektakolare nga minuta e parë deri në të fundit. E menaxhuam ndeshjen shumë mirë. Mendoj se ishte ndeshja jonë më e kompletuar këtë sezon dhe patjetër më e mira”, ka thënë Zidane.

#### Conte: Na mungoi vetëm goli

Interi eliminohet për të tretin vit radhazi në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve. Madje klubi italian nuk është kualifikuar as në Ligën e Evropës, duke përfunduar në pozitën e fundit në tabelë. “Nuk na mungoi agresiviteti, skuadra dha gjithçka. E vetmja që e pabesueshme që na mungoi është fakti që në 180 minuta nuk arritëm t’i shënojmë asnjë gol Shakhtarit. Portieri i tyre ka qenë lojtari më i mirë në të dyja ndeshjet. Në këto momente ka vetëm zhgënjim, gjërat e tjera do t’i analizojmë në të ftohtë”, u shpreh Conte.

#### Pau Gasol: Kam dëshirë të luaj më vëllanë tim për Lakersat

Basketbollisti spanjoll Pau Gasol ka luajtur për 7 sezone me Lakersat (2008-2014), duke fituar dy tituj kampionë në NBA (2009, 2010). Në atë kohë, me ekipin kalifornian luante edhe Kobe Bryant dhe ata të dy formuan një dyshe fituese. 40-vjeçari spanjoll nuk luan prej një viti (hera e fundit në NBA me Milwaukee). Gjithsesi, ai është gati të rikthehet në fushë dhe të luajë sërish me Lakersat, ku pak ditë më parë firmosi edhe vëllai i tij Marc Gasol. “Do të ishte diçka speciale të luaja sërish me Lakersat dhe të luaja më vëllanë tim Marc. Gjithsesi, jam në një pozitë që nuk mund të kërkoj shumë. Nuk kam 10 kontrata dhe mund të zgjedh. Dua të ndiej që ekipi ka nevojë për mua. Dua të argëtohem duke luajtur”, ka thënë Pau Gasol.

#### PSG-ja ‘blindon’ Neymarin dhe Mbappen

Sulmuesit Neymar dhe Kylian Mbappe do të mbesin te Paris Saint-Germaini dhe këtë e ka konfirmuar edhe presidenti i klubit francez, Nasser Al-Khelaifi. Sipas tij, si Neymar edhe Mbappe kanë shprehur dëshirën për t’i qëndruar besnikë klubit dhe tashmë kanë filluar negociatat për vazhdimin e kontratave. Që të dy sulmuesit kanë kontratë me kampionin e Francës deri në vitin 2022. “Ne i kemi nisur bisedimet me Neymarin dhe Mbappen për vazhdimin e kontratave dhe jam shumë i bindur që marrëveshja do të arrihet. Ata duan të mbeten në klub dhe ne jemi të lumtur që në radhët tona t’i kemi dy prej sulmuesve më të mirë në botë”, është shprehur Al-Khelaifi. Mbappe këtë edicion ka shënuar 12 gola dhe ka asistuar tetë herë në 14 ndeshje, ndërsa Neymar ka shënuar nëntë gola në 11 paraqitje në të gjitha garat.

Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e në e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer. *Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*

Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*

Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt

*Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj*

Alice Whitmore, përkthyesë e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. - *Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*

Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretexti i poezisë pamfletuese të oportunitizmit lirik

*Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a anunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de panfletarias poetas de oportunismos líricos*

Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*

Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh të lexuesit, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë

*La poesía de Xhevdet Bajrajt estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida*

Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*  
Shqiptar Oseku, poet. - *Poeta*

6<sup>99</sup> €



**KAFE ME NËNËN  
CAFÉ CON MAMÁ**

XHEVDET BAJRAJ



XHEVDET BAJRAJ

**KAFE ME NËNËN** poezi



**CAFÉ CON MAMÁ** poesia

Parathënien/ Prólogo: Adil Olluri



Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjane njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor reviste, drejtor televizionit, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjetë antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndër mend ta pensionojë.

Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.

*Lakorja e fatit* çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturalisht tre kapitujt pasues: *Terr, Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motive, ideore dhe përmbajtjesore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimitarisë tregimtare, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).

4<sup>99</sup> €



Dr. Emin Z. Emini

LAKORJA E FATIT

ADEM GASHI

ADEM GASHI

**LAKORJA E FATIT**  
(Tregime, rrëfenja dhe parabola)



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "TOI 4" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurëve të fortë –Andeziteve në Murgullë, Podujevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.01.2021 në ora 10:00 në hapësirat e zyrës së kompanisë "TOI 4" Sh.p.k Pn. në Podujevë do të organizohet debat publik nga kompania "TOI 4" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurëve të fortë –Andeziteve në Murgullë, Podujevë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WEtvcTIOMSs1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Trim Jakup Reka shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me nr. 564.
- ▶ Drilon Qafleshi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - V shf " Emin Duraku " Prizren.
- ▶ Drilon Qafleshi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX shf " Leke Dugagjini " Prizren.
- ▶ Driton Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abirapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

